



PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

E-BULETINI

mars 2011

Kosovo Bans Smoking in Public Places, including Bars

“A të pengon nëse pi duhan? A të pengon nëse vdes?”

Dalja me shokë për një kafe ishte një gjë që Arbnor Hasani nuk ka mundur ta bëjë shpesh. Ai jo vetëm që nuk e pin duhanin por edhe është alergjik ndaj tymit të duhanit, gjë që atij ia bën të pamundshëm qëndrimin për më shumë se disa minuta në kafene, bar apo cilëndo hapësirë të brendshme publike në Prishtinë. Kjo tani është duke ndryshuar falë Qendrës për Avokim dhe Zhvillim në Kosovë (KADC) të mbështetur nga ISC dhe iniciativës së saj avokuese “Mbrojtja e shëndetit publik nga duhani”.

Që nga hyrja në fuqi katër vite më parë e Ligjit për Duhanin nuk ka pasur ndryshime të mëdha. Duhanshijnjtë kanë pasë mundësi të pijnë duhanin çdokund, madje edhe në hapësirat e brendshme të qendrave shëndetsore dhe institucioneve arsimore. Ekipi i ekspertëve i KADC-së e identifikoi nevojën jashtëzakonisht të madhe për përmirësimin e kësaj gjendje.


Gjatë 18 muajve të fundit KADC ka arritur ndryshime të mëdha në procesin e implementimit të Ligjit ekzistues për duhanin. KADC rekomandoi ndryshime dhe shtesa në Ligjin ekzistues, të cilat janë përfshirë në Ligj dhe miratuar nga Komisioni parlamentar për shëndetësi.

KADC ka avokuar për zbatimin e këtij Ligji tek Ministria e Shëndetësisë dhe Inspektorati Sanitar, dhe si rezultat u imponua ndalesa e pirjes së duhanit në hapësirat e brendshme publike, institucionet arsimore dhe shëndetsore si dhe në restorane, në përputhje me Ligjin ekzistues për duhanin.

Dhjetra fëmijë me sindromin Down integrohen në shkollat e Kosovës

“Kam dëshirë të bëhem mësuese!” ...

Thotë shpesh njëmbëdhjetë vjeçarja Mjalta Bajraktari. Deri në nëntorin e vitit 2010 kjo do të ishte një dëshirë e parralizueshme e Mjaltës e cila pasi që është e prekur me sindromin Down nuk ishte e



“Ne jemi shumë krenarë për rezultatet e arritura, sidomos për vetëdijen e lartë të popullatës si dhe pjesëmarrjen e tyre aktive. E kemi vërejtur një ndryshim dramatik në qëndrimin e popullatës ndaj ligjit për ndalimin e pirjes së duhanit prej fillimit e deri në fund të projektit. Gjithashtu jemi tejet krenar që shumë e më shumë njerëz kanë filluar të besojnë në suksesin e këtij ligji.” Shkumbin Spahija, drejtor ekzekutiv i KADC-së.

Përveç kësaj, KADC ndihmoi Inspektoratin në përpilimin e urdhërit për ndalimin e pirjes së duhanit, i cili është transmetuar në Televizionin publik. Krahas kësaj, kjo organizatë përgatiti edhe fletushka të cilat e promovuan ndalesën e shitjes së produkteve të duhanit personave nën 18 vjeç, të cilat Inspektorati ua ka shpërndarë duhan shitësve.

përfshirë në sistemin arsimor të Kosovës.

Down Syndrome Kosova (DSK) e mbështetur nga ISC e mundësoi realizimin e ëndrrës së Mjaltës së bashku me dëshirat e shumë fëmijëve tjerë.

Me projektin e tyre “Arsimi gjithpërfshirës: Politikë nacionale, apo vetëm ide?” **Vazhdon në faqen 2**



DSK ua hapi dyert atyre të cilëve u është mohuar e drejta për arsimim vetëm për shkak të aftësive të tyre të kufizuara.

Për më tepër, DSK ka inicuar dhe koordinuar hartimin e strategjisë pesë vjeçare (2010-2015) për arsimin gjithpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, e cila u miratua nga Ministria e Arsimit, Shkencave dhe Teknologjisë (MEST) në maj të vitit 2010.

Pas miratimit të strategjisë, Ministria së bashku me DSK -në dhe Save the Children organizoi një konferencë nacionale për arsimimin gjithpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjatë konferencës përfaqësuesit e MEST lavdëruan DSK-në si iniciatorë të strategjisë 5 vjeçare. Përveç strategjisë, DSK koordinoi edhe hartimin

e dy dokumenteve tjera shumë të rëndësishme: Planin e Individualizuar Arsimit si dhe udhëzuesin përkatës. Me 31 janar 2011, DSK mbajti një konferencë për të gjeturat dhe suksesin e projektit të tyre.

“Përmes projektit tonë 19 fëmijëve u mundësua regjistrimi në paralelet para-shkollore, ndërsa 20 fëmijë u regjistruan në shkolla fillore. Të gjithë fëmijët janë shumë të lumtur. Prindërit dhe mësuesit e tyre janë tejet të kënaqur dhe besojnë se mënyra e vetme që këta fëmijë të zhvillojnë potencialin e tyre është duke ndjekur mësimin në institucionet e përgjithshme arsimore,”
Leonora Shabani nga Grupi i Prindërve të DSK-së.

Kur Mjalta është pyetur se çfarë i pëlqen më së shumti në shkollën e saj të re, ajo tha: “Më pëlqen mësuesja dhe Qëndrimi”, i cili është një djalë në klasën e saj.

Duke iu falenderuar mbështetjes së ISC-së përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë, të financuar nga USAID, dhe angazhimit e punës së DSK-së, djemve dhe vajzave sikurse Mjalta u është mundësuar realizimi i dëshirave të tyre.

U themelua zyra rajonale për llogaridhënie nga qeveria

Syri i Vizionit (SiV) ka identifikuar nevojën e komunikimit ndërmjet qeverisjes në nivel qendror dhe lokal për t'i mundësuar këtij të fundit përfaqësimin e interesave të elektoratit lokal.

“E kemi vërejtur që niveli qendror ka pak njohuri për qështjet lokale dhe nevojat e qeverisjes lokale, grupeve të ndryshme të interesit, dhe vet komunitetit”, Veton Mujaj, Drejtor Ekzekutiv i SiV

Sipas Mujaj, qëllimi përfundimtar i një projekti të tillë është të mundësoj implementimin më të lehtë të ligjeve, duke marrë parasysh se ato janë hartuar duke i konsideruar rrethanat specifike në të cilat jeton komuniteti lokal. Përveç kësaj, parlamentarët do të mbanin përgjegjësinë si dhe procesi i ligjvënies do të ishte më transparent.

SiV ka themeluar një zyrë rajonale në Pejë e cila shërben si pikë kontakti për Anëtarët e Kuvendit të Kosovës si dhe autoriteteve lokale dhe qytetarëve. Ajo gjithashtu shërben si projekt fillestar i cili më vonë mund të përseritet në rajonet tjera të Kosovës. Qytetarët e Pejës e mirëpritën hapjen e zyrës rajonale dhe vazhdimisht kërkojnë takime me ministrat, thotë Mujaj. Përveç shfrytëzimit të zyrës rajonale si një lidhje në mes



veprimtarëve të nivelit qendror dhe atij lokal, SiV gjithashtu e shfrytëzoi zyrën si kanal për avokimin e një amendamenti për Ligjin e Pylltarisë së Kosovës. SiV së bashku me të gjitha palët e interesuara e nxiti Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Agrikulturë, Pylltari dhe Zhvillim Rural të bëjë presion në Kuvendin e Kosovës për hartimin e Ligjit të ri për Pylltari. Si pjesë e një ekipi punues SiV i ofroi 30 rekomandime për përmirësimin e ligjit ekzistues në përputhje me rregullat e BE-së. Projektligji i ri i cili i përfshinë edhe rekomandimet e SiV i është dorësuar Kuvendit të Kosovës.

Për më shumë informata vizitoni: www.syrivizionit.org

Ekspertë të mediave trainojnë OJQ-të partnere të K-CSSP-së për përdorim

Më shumë se 40 pjesëmarrës, të tubuar nga Programi për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë (K-CSSP) gjatë dy trajnimeve të mbajtur në Prishtinë më 22 - 24 shkurt dhe në Mitrovicë më 1 dhe 2 mars, mësuan se si të komunikojnë në mënyrë efektive me mediat.

I dizajnuar në mënyrë që t'i plotësojë nevojat si të OJQ-ve shqipfolëse ashtu edhe për ato që flasin gjuhën serbe, trajnimi u ofroi organizatave partnere të K-CSSP njohuri praktike për marrëdhëniet me mediat elektronike dhe të shtypura. Trajnimi u zhvillua nga gazetarë dhe redaktorë prominent të gazetave dhe të televizionit të cilët kanë përvojë direkte me nevojat dhe prioritetet e sektorit të OJQ-ve. Pas trajnimit, OJQ-të pjesëmarrëse do të jenë në gjendje të informojnë më mirë qytetarët për punën që bëjnë, si dhe të shtojnë mbështetjen e atyre që përfaqësojnë për presion më të madh publik mbi vendimmarrësit.

Filmimi i intervistave, gjatë së cilave u stimuluan kushtet reale të studios televizive, arritën kulminacionin e trainimit. Pjesëmarrësit i ushtruan dhe i përmirsuan aftësitë e tyre prezantuese para kamerës.

Gjatë këtij trainimi tejet praktik, Partnerët për Avokim Kombëtar, Partnerët për Avokim Lokal dhe

“ Ushtrimi para kamerës televizive ishte pjesa më sfiduese dhe më e dobishme e trajnimit, diçka që kurrë më parë nuk e kam pasur rastin ta bëj. Ajo jo vetëm që më ndihmoi të sjellëm më mirë para kamerës, por edhe ta përcjelli mesazhin tim në mënyrë precize, të shkurtër dhe të artikuluar.”
Milan Milosavljeviq nga OJQ-ja Aktiv



përfituesitë e Fondit për Nisma të Veçanta të K-CSSP, së bashku me anëtarët e Rjetit të Aksionit për Politika në Kosovë (KPAN), prezantuan sukseset e arritura me ndihmën e K-CSSP-së, të cilat do t'i ndajnë tutje me përfaqësuesit e tyre dhe publikun e gjerë përmes mediave online të ISC-së dhe partnerëve si dhe gjatë evenimenteve të ndryshme të projekteve.

Trajnimet për komunikim me media dhe prezantim televiziv janë pjesë e përkrahjes së ISC-së për ngritje të kapaciteteve të OJQ-ve në tërë Kosovën përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë të financuar nga USAID.



Lëvizja FOL publikoi raportin e parë vjetor “Monitoruesi i Korrupsionit”

Lëvizja FOL publikoi raport vjetor për përpjekjet kundër-korrupsionit të ndërmarra në Kosovë gjatë vitit 2010, gjatë një diskutimi të organizuar në Prishtinë më 23 shkurt 2011.

I titulluar “Monitoruesi i Korrupsionit 2010”, raporti është produkt i monitorimit sistematik një vjeçar nga Lëvizja FOL i luftimit të korrupsionit nga institucione

të ndryshme publike të Kosovës.

Kjo lëvizje joqeveritare iu prezantoi të gjeturat e raportit pjesëmarrësve të tryezës, të cilët janë përfaqësues të institucione të përfshira në luftimin e korrupsionit: Prokuroria, Agjensioni Kundër-korrupsionit, Policia, Qeveria, Gjyqi, Dogana, Organizatat e shoqërisë civile, etj.

Lëvizja FOL publikoi raportin e parë vjetor “Monitoruesi i Korrupsionit”

“Progresi i arritur në luftimin e korrupsionit ka qenë i kufizuar dhe i pamjaftueshëm në krahasim me nivelin e lartë të korrupsionit prezent në institucionet e Kosovës, “Armend Mazreku nga Lëvizja FOL, duke iu referuar përmbledhjes së raportit “Monitoruesi i Korrupsionit”



Media të ndryshme shtypi dhe televizione e mbuluan ngjarjen, gjë që i mundësoi Lëvizjes FOL të arrij deri tek publiku i gjërë.

Lëvizja Fol ka monitoruar luftimin e korrupsionit në Kosovë dhe ka publikuar raporte mujore për këtë çështje që nga janari 2010. Kjo nismë për monitorimin e korrupsionit është pjesë e Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë, i implementuar nga ISC dhe financuar nga USAID, i cili synon që publikisht t'i mbështesë aktivitetet kundër korrupsionit të ndërmarra nga Parlamenti, Qeveria dhe Gjyqësori. Gjithashtu, ai synon të monitorojë dhe fuqizojë marrëdhëniet e këtyre institucioneve në luftën kundër korrupsionit.

Më shumë informata për aktivitetet e FOL në: www.levizjafol.org

Evenimentet e ardhshme të K-CSSP

- Eveniment i promovimit publik të OJQ-ve pjesëmarrëse në K-CSSP – prill 2011



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



INSTITUTE FOR
**Sustainable
Communities**

PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

Programi për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë (K-CSSP) ka për qëllim të sigurojë që shoqëria civile në Kosovë të bëhet partner efektiv dhe me ndikim i qeverisë në vendimmarrjen publike, si dhe në formësimin e agjendës legislative dhe të politikave.

Organizatat joqeveritare (OJQ-të) pjesëmarrëse në K-CSSP trajtojnë një varg të gjerë çështjesh, duke mëtuar që qeveria të japë llogari para qytetarëve të saj, si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal. K-CSSP është themeluar më 2008 dhe realizohet nga Instituti për Komunitete të Qëndrueshme, i cili mbështet OJQ-të nga të gjitha pjesët e Kosovës përmes dhënies së granteve, ngritjes së kapaciteteve, si dhe duke punuar në kornizën ligjore për organizatat e shoqërisë civile. K-CSSP financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Shkrimet nga lartë paraqesin aktivitetet e fundit të nismave të avokimit të mbështetura nga K-CSSP, të cilat adresojnë çështje me prioritet të lartë për Kosovën.

Ky publikim është mundësuar përmes Misionit në Kosovë të Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar. Opinione të shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

INSTITUTE for SUSTAINABLE COMMUNITIES - KOSOVO

Fehmi Agani 35, Pristina, Kosovo
+381 38 745 702
office@isckosovo.org